

Një kopsht për fëmijët e fshatit Bllaçë, Peshkopi

42 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç, që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, frekuentojnë arsimin parashkollor brenda ambjenteve të shkollës së vetme 9-vjeçare të fshatit Bllaçë. Ambjentet e pashtuara me pllaka, pa tavolina e karrige të përshtatshme për trupin e fëmijëve, pa lodra dhe mjetet e nevojshme didaktike për zhvillimin e tyre, kanë nevojë për mbështetje për të siguruar kushte optimale për edukimin dhe socializimin e fëmijëve.



Organizata zbatuese e projektit është **Vizion OJF**, Tiranë.

Adopto një terapi! - Mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale

Në qendrën e Arritjeve dhe Zhvillimit të **Fondacionit Down Syndrome Albania (DSA)** marrin shërbime 38 fëmijë me sindromën Down, fëmijë me spektrin e autizmit dhe vështirësi të tjera në të nxënë. Shërbimet që ofrohen përfshijnë terapi okupacionale, terapi zhvillimi, logopedi, terapi fizike, terapi ABA. Situata është emergjente! Down Syndrome Albania, nuk ka fonde të mjaftueshme për shërbimet duke filluar nga data 1 dhjetor.



Më shumë se kurrë kemi nevojë për mbështetjen tuaj!

Çdo donacion i mundshëm do të thotë ofrim shërbimesh të domosdoshme për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, për t'u mundësuar atyre zhvillimin drejt një jete të pavarur dhe gjithëpërfshirëse.

Edukimi dhe integrimi i fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian përmes sportit

Mbi 30 fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, të grupmoshës 10-13 vjeç, stërviten pranë ekipit sportiv të futbollit të ngritur në Shkodër prej disa muajsh. Ky ekip futbollit ka krijuar një shembull pozitiv në komunitet duke nxitur ndjenjën e përfaqësimit për anëtarët e këtyre komuniteteve, uljen e braktisjes së shkollës, minimizimin e bullizmit dhe promovimin e rregullave 'fair-play' në fushë dhe në jetë për këta fëmijë. Këta të rinj të talentuar kanë nevojë për pajisjet dhe ambjentet e duhura sportive për të siguruar jetëgjatësinë e ekipit.



Iniciativa zbatohet nga **Shoqata për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian**, Shkodër